



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

#### **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 09.04.2019, ora 10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Milva Ekonomi - nënkryetare e Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 1 prill 2019.
2. Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, zonjën Besa Shahini, për çështje që lidhen me arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë.

#### **Marrin pjesë:**

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Anduel Xhindi (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Musa Ulqini, Vilma Bello, Bujar Çela.

#### **Të ftuar:**

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Redi Shtino – zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Zamira Gjini – drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë,  
Eridon Kotri – këshilltar i Ministres për Medien.

## HAPET MBLEDHJA

**Milva Ekonomi** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Sot kemi mbledhjen e radhës të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Në rendin e ditës kemi tri çështje: miratimin e procesverbalit të datës 1 prill; seancën dëgjimore me ministren e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, zonjën Besa Shahini, lidhur me rezultatet e “Paktit për universitetin” dhe përgatitjet për maturën shtetërore, si dhe çështja të tjetra që lidhen me problematika të komisionit.

Përpara se të bëjmë komente apo pyetje për materialin që ka sjellë Ministria e Arsimit për dy çështjet që kemi kërkuar, ia japim fjalën ministres për të parashtruar shkurt të gjitha këto arritje, problematika ose rezultate, të cilat ju i keni sjellë nëpërmjet shkresës, ku na vini në dijeni për “Paktin me universitetin” dhe për përgatitjet për Maturën shtetërore 2019.

Fjala është për ju, zonja Shahini.

**Besa Shahini** – Ju falënderoj shumë për ftesën tuaj për t’u paraqitur në komision që të diskutojmë bashkë me ju për arritjet e “Paktit”, sfidat dhe mënyrën se si do të ecim para!

Me mua sot janë: Redi Shtino, zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që mbulon arsimin e lartë dhe Zamira Gjini, e cila është drejtoreshë e Përgjithshme në ministrinë tonë dhe mbulon maturën shtetërore.

Më 18 prill bëhen 3 muaj nga lançimi zyrtar i “Paktit për universitetin”. “Pakti për universitetin” nisi si një draftdokument i ofertës që qeveria solli në publik, si përgjigje ndaj kërkesave të protestës së studentëve të dhjetorit të vitit 2018. Studentët artikuloan disa çështje, por ajo që u artikulua më qartë ishte se ne paguajmë shumë për cilësinë që marrim. E morëm shumë seriozisht këtë pjesë dhe vendosëm t’u vinim në ndihmë familjeve, që paguajnë për arsimimin e fëmijëve të tyre dhe do të ofrojmë një pako financiare, e cila ka disa elemente: përgjysmimin e tarifës për të gjithë studentët që janë në cikël të parë apo të integruar të studimeve, përjashtimin nga tarifa të të gjithë studentëve që janë ekselentë, që kanë mesatare nga 9-10, si dhe të studentëve që vijnë nga kategori në nevojë, pra ose janë me asistencë ekonomike, ose kanë nevoja të veçanta, ose i përkasin ndonjë kategorie të tjera në nevojë, sipas përcaktimeve të Ministrisë së Shëndetësisë. E fundit, kemi ndarë edhe bursa prej 10 mijë lekësh të rinj për dy kategoritë e fundit: për studentët

ekselentë dhe për studentët në nevojë. Për studentët e ciklit të dytë ka përgjysmim tarife për më të mirët, pra të shkëlqyeshmit dhe për ata që janë në nevojë. Kjo pako financiare kap vlerën e 2,3 miliardë lekë të rinj. Disbursimi ka filluar që në janar. Muaji i parë ishte pak i ngadaltë, për shkak se ka shumë punë nëpër sekretaritë e universiteteve dhe fakulteteve të ndryshme për të mbledhur të gjithë informacionin për secilin student, pra të bëjnë kalkulimet e mesatareve, të shohin dokumentacionin nëse studenti i përket njërës prej kategorive që përfiton, kështu që muajtë janar dhe shkurt kanë pasur disa ngadalësime në procesin e disbursimit të bursave. Tani është stabilizuar situata dhe jemi shumë më mirë lidhur me këtë disbursim. Është një grup i studentëve që ende nuk i ka marrë bursat, por që u takon. Një pjesë e tyre nuk i kanë hapur llogaritë bankare. Unë i ftoj, sa herë që kam mundësi të flas publikisht, do t'ua bëj edhe sot ftesën, që studentët të shohin sa më shpjet pranë sekretarive nëse janë përfitues të bursave, të hapin llogaritë bankare, që të mund të përfitojnë bursën që u takon.

Një kërkesë tjetër që kishin studentët, ishte përfaqësimi i tyre. Ata donin të merrnin pjesë në mënyrë më aktive në vendimmarrjet në universitetet e tyre. Ata donin përfaqësim më të lartë në senat dhe në bordet e administrimit. Ne e dëgjuam me shumë kujdes edhe kërkesën për bordet e administrimit, ku vendimet janë kryesisht të natyrës financiare, pra është një mbikëqyrje e shpenzimeve të buxhetit publik; nuk pamë ndonjë model ku studentët të përfaqësohen në këtë nivel. Që t'u përgjigjemi kërkesave të studentëve, vendosëm të bëjmë diçka tjetër, ristrukturoam plotësisht bordet, pra i liruar nga detyra të gjithë anëtarët e bordit që ishin përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë; hapëm një konkurs publik, ku aplikuan personalitete të ndryshme që janë të shquar në fushat e tyre, në drejtësi, ekonomi etj., për të qenë anëtarë të bordit. Kemi pasur dy raunde të aplikimit. Në raundin e parë kanë qenë mbi 120 aplikantë, në raundin e dytë mbi 80 aplikantë dhe kemi arritur t'i zëvendësojmë të gjithë anëtarët, që ishin përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nëpër bordet e administrimit. Procesi ka qenë tërësisht i hapur e transparent dhe jemi të lumtur me rezultatet. Në tri universitete studentët e kanë zgjedhur përfaqësuesin e tyre, pra kjo ishte oferta jonë: do t'i zëvendësonim të gjithë anëtarët e bordeve dhe një anëtar do të jetë i përzgjedhur nga studentët. Në universitetet ku studentët u organizuan, i sollën kandidaturat, pra, organizuan procesin zgjedhor dhe na i sollën kandidaturat e tyre, prej të cilëve ne zgjodhëm një përfaqësues tonin, i cili ishte edhe përfaqësues i studentëve. Në ato universitete studentët do të kenë qasje direkt me vendimet e bordit në një mënyrë shumë më të drejtpërdrejtë. Bëj përsëri thirrje që edhe universitetet e tjera, të cilat nuk kanë arritur të bëjnë përzgjedhjen e një

anëtari të bordit, që është përfaqësues i studentëve, të organizohen sa më shpejt, të kalojnë në procesin e votimit dhe të na sjellin kandidaturat e tyre.

Një mënyrë e mirë për përfshirjen jo vetëm të studentëve, por edhe të pedagogëve në vendimmarrjen nëpër universitete është edhe portali “U-transparenca.al”, ku botohen të gjitha vendimet që merren në nivel universiteti. Ky *website* përmban vendimet që kanë të bëjnë me financat, me bursat dhe vendimet e tjera të senatit, që merren në nivel universiteti, CV-të e pedagogëve dhe çfarëdo informacioni tjetër që mund t’ju interesojë edhe pedagogëve, edhe studentëve, siç janë bursat, marrëveshjet me shtetet e tjera apo me organizatat e tjera. Ky portal u vjen në ndihmë të gjithë studentëve, të cilët duan të marrin pjesë në mënyrë më aktive në vendimmarrjen e universitetit të tyre, sepse realisht informimi është gjëja kryesore në këtë mes. Në faqen e parë të portalit është edhe rubrika “Ankesa ime”, ku studentët mund të ankohen për çdo problematikë që hasin nëpër universitetet e tyre dhe mund të shohin edhe komente për mënyrën se si po funksionon portali. Deri tani ky portal ka pasur informacion administrativ dhe akademik. Të gjitha universitetet kanë persona kontakti, që hedhin informacionin e përditësuar çdo muaj si nga aspekti administrativ, që ka të bëjnë me vendimet financiare, si nga aspekti akademik, që ka të bëjë me CV-të e pedagogëve dhe pjesët e tjera. Ky portal po zgjerohet me informacion. Ne kërkojmë që të kemi sa më shumë persona që e aksesojnë portalin dhe të çojnë komente. Një koment që na ka ardhur nga disa studentë është që nuk është shumë *user friendly*, që do të thotë se nuk mund të përdoret lehtësisht. Ne po bëjmë ndryshimet e fundit teknike, në mënyrë që të jetë sa më i lehtë në përdorim edhe në telefon, sepse në desktop punon shumë më mirë.

Biblioteka digjitale, të cilën e lançuan javën e kaluar, është edhe realizimi i kërkesës kryesore që ka të bëjë me cilësinë e arsimit. Kërkimi akademik është pjesa kryesore që siguron përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë. Përderisa ka aq shumë resurse shkencore, që janë të nevojshme për fushat ku studiohet në Shqipëri, nuk mund të bazohemi vetëm në një libër që pedagogu ofron për një lëndë të caktuar. Biblioteka digjitale ka miliona artikuj shkencorë, qindra mijëra revista dhe libra akademike dhe përmban module për mësimin e gjuhës së huaj në 30 gjuhë. Kjo u mundëson studentëve që të përforcojnë anglishten dhe të mund të përdorin këtë platformë. Të gjithë kanë akses falas dhe deri tani janë 40 000 studentë aktivë, ku 70 000 prej tyre janë të njoftuar me e-mail që kanë akses. Gjatë javës së kaluar ka pasur rreth 6 mijë kërkime të bëra në *website*. Ne do të vazhdojmë të promovojmë bibliotekën digjitale, në mënyrë që sa më shumë studentë dhe sa më shumë pedagogë ta përdorin atë. Studentët ishin dakord për një bibliotekë

digjitale, por thanë që kanë nevojë edhe për libra në gjuhën shqipe, ndaj është themeluar edhe një grup pune që merret me identifikimin e literaturës së huaj, librave ikonikë për fusha të ndryshme, që mund të përkthehen dhe të përdoren në universitete. Ne kemi një model shumë të mirë nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ku bashkë me Fakultetin Ekonomik kanë bërë një marrëveshje me një grup pedagogësh, të cilët kanë menduar që një numër librash, të cilët përdoren në universitete të ndryshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të përkthehen dhe të përdoren për lëndët e ndryshme të ekonomisë në Fakultetin Ekonomik, në Universitetin e Tiranës. Kjo ka funksionuar mirë, por është një proces që zgjat, sepse përkthimi i mirëfilltë merr kohë dhe është proces i kushtueshëm. Nëse ne arrijmë ta përfundojmë deri në fund të muajit prill, ashtu siç e kemi parashikuar, të identifikojmë librat ikonikë për fusha të ndryshme, shumë shpejt mund të fillojmë me përkthimin, të cilin do ta bazojmë tërësisht në modelin që e kemi marrë nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Investimet infrastrukturore janë, gjithashtu, të nevojshme jo vetëm në kampusin e Universitetit të Tiranës, por edhe në kampuset e universiteteve të tjera.

Universitetet, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe me ministrinë e tjera, kanë zhvilluar një proces takimesh të rregullta, që kanë filluar në janar dhe janë mbyllur në muajin mars, lidhur me identifikimin e nevojave infrastrukturore. Ne e dimë se nevojat infrastrukturore janë për zgjerim të kampuseve, për zgjerim të laboratorëve dhe për pajisje të laboratorëve. Jo të gjitha universitetet i kanë sjellë projektet, të cilat janë gati për t'u investuar në to dhe jo të gjitha kanë mundësi që të financojnë kompani që t'i projektojnë këto projekte dhe t'i bëjnë gati për investime. Kështu që, si hap i parë kemi vendosur që të vëmë në dispozicion një fond, që të kontraktojmë kompani apo arkitektë vendorë dhe të huaj, që të mund të bëjnë projektet dhe kalkulimin financiar për nevojat për investime infrastrukturore nëpër të gjitha universitetet, jo vetëm në Tiranë, por edhe jashtë Tiranës.

Sipas planeve tona, i gjithë ky proces do të mbyllet në shtator, kështu që në muajin tetor ne mund t'i kemi filluar investimet e para. Siç e dini, i gjithë instrumenti financiar që ka qenë i parashikuar për ndërtimin e rrugës Thumanë-Kashar është vendosur në dispozicion të investimeve për universitetet dhe ne jemi të lumtur për këtë, sepse e dimë që ai mund të realizohet. Në momentin e parë që ne i kemi projektet gati, ky instrument do të vihet në funksion dhe do të fillojnë edhe investimet e para infrastrukturore. Që pakti të realizohet siç duhet, ne kemi hartuar disa kontrata apo marrëveshje me universitete të ndryshme dhe këto marrëveshje apo kontrata

nënshkruhen midis ministrive përkatëse dhe fakulteteve që mbulojnë fushën e ngjashme me ministrinë përkatëse. Ministria e Arsimit i mbulon të gjitha universitetet që janë jashtë Tiranës dhe ajo që përmban kjo marrëveshje janë jo vetëm detyrat që kemi marrë ne, si qeveri, por edhe detyrat dhe obligimet që kërkojmë nga universitetet që t'i realizojnë. Shembull për këtë marrim akreditimin, përderisa të gjitha universitetet kanë kryer akreditimin institucional, i cili siguron cilësinë..., jo të gjitha universitetet kanë filluar akreditimin e programeve specifike, që është edhe pjesa më e rëndësishme, sepse nga akreditimi matet edhe cilësia e arsimit dhe cilësia e mësimdhënies. Ne kemi kërkuar që të gjitha universitetet, sa më shpejt të jetë e mundur, të fillojnë procesin e akreditimit të programeve dhe ky cikël akreditimi të mbyllet brenda dy vjetëve të ardhshëm. Ne shpresojmë që edhe studentët të jenë të gatshëm dhe aktivë nëpër universitetet e tyre dhe të kërkojnë më shumë nga udhëheqësit e universiteteve.

Një çështje, e cila është ngritur vazhdimisht, ka të bëjë me titujt akademikë, gradat shkencore, integritetin e disertacioneve, si dhe integritetin e marrjes së titujve akademikë. Lidhur me këtë ne kishim dje një takim me të gjithë rektorët e universiteteve publike, sepse kjo nuk është një kërkesë që mund ta realizojmë ne, si Ministri e Arsimit, apo ne, si qeveri, por duhet të realizohet nga universitetet dhe ne të vihemi në dispozicion të tyre për çdo gjë që mundemi, në mënyrë që ta kalojmë këtë proces në mënyrën më të mirë të mundshme. Duhet të shihet integriteti i disertacioneve përmes një *softuer*-i që kontrollon plagjiaturën dhe duhet të shihet edhe ligjshmëria e marrjes së titujve akademikë. Rektorët ishin dakord që duhet të bëhet diçka dhe jemi në proces të marrjes së ideve më të mira që të fillojmë një proces, i cili do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë më shumë sesa ata që të jenë ndëshkues, sepse qëllimi nuk është që të jemi ndëshkues, por që të vendosim një standard sa më të mirë, për të rritur cilësinë e mësimdhënies në Republikën e Shqipërisë. Ne kemi kërkuar nga universitetet të na sjellin të gjitha doktoraturat që janë fituar në vitet e fundit dhe ata na kanë sjellë një listë, por jo të gjithën. Universiteti i Tiranës, i cili është universiteti që ka prodhuar më shumë doktoratura, ende nuk e ka sjellë listën e tij, ndaj jemi vazhdimisht në diskutime dhe kemi dialog me universitetet, që ta mbyllim hapin e parë të identifikimit të të gjitha disertacioneve që janë dhënë nga universitetet publike dhe private në Shqipëri.

Karta e studentit është një premtim që e kemi bërë, jemi vonuar pak në kalimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, që themelon bazën për realizimin e kartës së studentit. Kjo ka ndodhur pasi ne donim që të gjenim një mënyrë të mirë për të ngërthyer edhe bashkitë në prodhimin dhe në

realizimin e kartës së studentit. Bashki të ndryshme ofrojnë shërbime të ndryshme. Për shembull, Bashkia e Tiranës ka shërbimin e transportit, që ndoshta nuk e kanë bashkitë e tjera, ku kemi universitete. Tani kemi arritur në një marrëveshje me të gjitha bashkitë për mënyrën se si do të realizohet kjo. Gjithsesi, Ministria e Arsimit së bashku me Bashkinë e Tiranës do të fillojnë të lëshojnë kartat e para të studentëve në Tiranë dhe, më pas, nga ai model do të ndërtojmë edhe kartat e studentit për universitetet e tjera. Aty përfshihen përfitime të ndryshme, si nga shërbimet që ofrojnë institucionet publike, ashtu edhe shërbime që ofrojnë institucione të ndryshme private. Ne jemi të bindur se fillimi i vitit të ri shkollor 2019-2020 do t'i gjejë studentët e universiteteve publike me kartën e studentit.

Kemi tri pika shtesë, të cilat nuk janë kërkuar nga studentët në dhjetor, por i kemi ofruar për shkak se janë çështje që janë diskutuar ndër vite nga vetë studentët. Ata kanë ngritur shqetësimin e punësimit të tyre dhe thonë: “Mirë ne po mbyllim studimet, por më pas si do të punësohemi, sepse gjithmonë kërkohet eksperiencia e punës për të filluar punë diku?!”. Kështu që, ne kemi nisur dy programe: njëri që ka të bëjë me punësimin me kontratën 1-vjeçare të studentëve më të mirë, të shkëlqyer, në administratën publike, ku të gjitha vendet e lira të punës në administratën publike do të hapen, së pari, për studentët e shkëlqyer, për të punuar me një kontratë 1-vjeçare, për të fituar eksperiencën e punës dhe për të pasur mundësi, pastaj, të aplikojnë tek ato vende pune apo diku tjetër me një eksperiencë të fituar 1-vjeçare.

Praktikat e punës.

Është një praktikë 3-mujore, pas të cilës studenti fiton të drejtën të aplikojë për një vend pune. Ky është një program i vjetër, sivjet është viti i katërt që realizohet. Por ajo që kemi bërë sivjet, është ndryshe nga vitet e mëparshme, kemi rritur shumë numrin e pozicioneve për praktikat e punës. Pra, sivjet janë hapur diku 2 mijë pozicione për praktikat e punës për studentët dhe deri tani kemi sistemuar rreth 1 mijë aplikantë, nga 3 mijë e 50 që kanë qenë në total, dhe në javët në vijim do të sistemohen edhe të tjerët.

Studentët nga praktikat 3-javore, ashtu siç e thashë edhe më parë, do të kenë mundësi të aplikojnë në një vend pune. Kjo është një ndihmëse e madhe për ata që të futen në tregun e punës dhe të bëhet kalimi, pra të bëhet ura lidhëse mes studimeve dhe tregut të punës.

Me vendim të Këshillit të Ministrave kemi mundësuar prokurimin direkt të shërbimeve nga institucione të ndryshme publike, që të marrin shërbime nga universitete apo fakultete të ndryshme për studime, për konsulencë dhe për ndonjë gjë tjetër që ju nevojiten si shërbim, pra të

mos shkojnë direkt te tregu, por të shkojnë njëherë tek universitetet publike. Ne besojmë se kjo do të ndihmojë shumë në rritjen e financimit të projekteve të ndryshme në universitetet publike.

Unë do ta ndërpres këtu pjesën e “Paktit”, se dua të them edhe dy fjalë për Maturën dhe, më pas, do të dëgjoj mendimet tuaja.

Sivjet matura është ndryshe nga vitet e mëparshme, për shkak se për herë të parë po testohet matura me kurrikulën e re. Pra, gjimnazi punon plotësisht me kurrikulën e re, e cila synon ndërtimin e disa kompetencave deri në fund të klasës XII. Pra, e kanë ndërruar komplet mënyrën se si ligjërohet dhe se si mësohet në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare në Shqipëri. Domethënë, edhe testi si i tillë është i formuluar ndryshe, që t’i masë këto kompetenca, jo vetëm që të masë njohuritë. Për shembull, testi i gjuhës shqipe ka një tekst më të gjatë dhe nxënësi duhet që të gjejë kuptimin e tekstit apo të ndërtojë diçka mbi ato që gjenden në tekst më shumë sesa të japë përgjigje për njohuri, siç ka qenë më parë. Janë tri teste kryesore: gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë angleze dhe është një test me zgjedhje. Qysh nga viti i kaluar universitetet janë në dijeni, kështu që kur planifikojnë për mënyrën se si do ta pranojnë studentin, pra për kriteret hyrëse për studentët e vitit të parë, e marrin parasysh strukturën e re të maturës. Ajo që sivjet është risi, dhe shpresoj shumë që do të kemi mundësi ta realizojmë dhe nëse jo në qershor, gjithsesi në shtator, përsëri kemi një projekt me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim për kontrollin e testit në mënyrë digjitale, pra, skanimin e secilit nga testet e maturës dhe kontrollin digjital të tyre. Kjo do të ndihmojë shumë edhe në uljen e kostos së kontrollit të testit, si dhe do të lehtësojë shumë mënyrën se si ne bëjmë kontrollin e testit, por rrit edhe integritetin dhe cilësinë e kontrollit. Po punojmë fort që kjo të realizohet në qershor, pra në kohën kur përfundon edhe matura. Por edhe një herë, në qoftë se nuk e arrijmë në qershor, gjithsesi do ta bëjmë në shtator dhe vihet në funksion totalisht për vitin tjetër shkollor.

Unë po e mbyll këtu, mbase Zamira ka diçka për të shtuar për maturën dhe për organizimin në terren.

**Zamira Gjini** – Përshëndetje!

Në fakt, Matura shtetërore, sikurse e tha dhe zonja ministre, këtë vit është ndryshe nga një vit më parë: nuk janë më 5 provime, por janë 4 provime. Vitin e kaluar kanë qenë 3 provime të detyruara, 2 me zgjedhje, ndërsa këtë vit janë 3 provime të detyruara dhe 1 me zgjedhje. Por më kryesorja është se ka ndryshuar rrënjësisht edhe mënyra e pyetjeve të këtyre testeve të provimeve



të Maturës shtetërore, e cila është rrjedhim për shkak të ndryshimit të kurrikulës së gjimnazit, pra kurrikulës për arsimin e mesëm.

Në provimet e maturës shtetërore të këtij viti maturantët do të kenë, gjithashtu, edhe një menu më të shkurtër nga një vit më parë të listës së provimeve me zgjedhje. Në qoftë se vjet kishin 23 lëndë me zgjedhje, nga të cilat do të zgjidhnin 2, tani kanë vetëm 8 provime në listën e lëndëve me zgjedhje, nga të cilat do të zgjedhin vetëm 1 provim me zgjedhje.

Në fakt, matura shtetërore është shumë e rëndësishme për maturantët, pasi rezultatet e maturës shtetërore ndikojnë shumë në pranimin e maturantëve në programet e studimit të tyre në universitete, sepse mesatarja e maturës shtetërore luan një rol të rëndësishëm në mesataren totale të maturantit, që është një nga kriteret kryesore të pranimeve të tyre në universitet.

Në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka një Komitet të Maturës shtetërore, i cili organizon të gjithë procesin e saj, që nga realizimi i rregullores, se si funksionon kjo maturë, deri në realizimin e provimeve, që fillojnë nga 7 qershori deri më 24 qershor, pra për të katërta provimet e Maturës shtetërore.

Siç e thashë edhe në fillim, për këto teste të reja të Maturës shtetërore, që lidhen me kurrikulën e re, ne, si Komitet i Maturës Shtetërore, kemi marrë masa të realizojmë një pilotim të këtyre testeve. Pra, është bërë një pilotim i testeve në disa drejtori arsimore, në disa shkolla të mesme. Ndërkohë, të gjitha këto modele testesh u janë dërguar institucioneve shkollore, shkollave të mesme, që mësuesit të kenë mundësi të punojnë me nxënësit, me maturantët e tyre, me këto modele testesh për t'u përgatitur për Maturën shtetërore.

Nga pilotimi, në fakt nga studimi dhe raporti i pilotimit, ka rezultuar që këto teste janë mirëpritur si nga maturantët, ashtu edhe nga mësuesit, të cilët po punojnë me këtë kurrikulë të re. E them këtë, sepse për herë të parë kemi futur gjuhën shqipe, kështu që komplet testi i gjuhës dhe i letërsisë ka ndryshuar nga një vit më parë qoftë nga programi orientues për maturantët, por edhe nga mënyra e hartimit të testeve.

Maturantët, gjithashtu, kanë në dispozicion edhe programet orientuese, të cilat janë të shpallura edhe në faqen zyrtare të Institutit të Zhvillimit të Arsimit, i cili është institucioni që harton këto programe, por janë të njohur me to edhe nëpërmjet komiteteve të Maturës shtetërore, që ndodhen në çdo shkollë të mesme, në çdo gjimnaz të Shqipërisë.

Dua të përmend këtu edhe rolin ose punën që është bërë në shkolla lidhur me këshillimin e karrierës. Që në muajin shkurt, universitetet kanë filluar të promovojnë programet e tyre nëpër

shkolla dhe maturantët të orientohen drejt karrierës së tyre për mënyrën se si do të zgjedhin lëndët e Maturës shtetërore dhe, më pas, si do të zgjedhin programet në universitete.

Aktualisht ka mbaruar procesi i regjistrimit të maturantëve nëpërmjet formularit A1 dhe A1Z, ku janë regjistruar rreth 40 mijë maturantë. Ka qenë një sistem *online* nëpërmjet sistemit *e-albania*, i cili rezultoi pa asnjë problem, madje maturantët, pasi bënë regjistrimin, patën edhe një pjesë të dytë, ku verifikuan edhe njëherë rezultatet e tyre qoftë me të dhënat personale, qoftë edhe me lëndët e provimit me zgjedhje që kishin plotësuar në këtë formular.

Tani jemi në momentin kur marrim masa për administrimin e Maturës shtetërore. Janë përcaktuar të gjitha qendrat ku do të zhvillohen provimet e maturës shtetërore në të gjithë Shqipërinë, në të gjitha drejtoritë arsimore rajonale, si dhe ka filluar trajnimi i të gjithë personave që angazhohen në këtë proces, duke filluar nga ata që hartojnë testet, deri tek administratorët e provimeve të maturës shtetërore apo sekretuesit e provimeve të maturës shtetërore.

Gjithashtu, është krijuar fondi i pyetjeve të Maturës shtetërore. Është një fond që krijohet nga ekspertë të trajnuar të licencuar, që janë mësues të shkollave të mesme, të cilët hartojnë një fond të pyetjeve të Maturës shtetërore, i cili u shërben atyre që hartojnë testin e Maturës shtetërore, i cili bëhet me një sistem digjital nga ky fond pyetjesh. Pra, është pikërisht një sistem që përzgjedh pyetjet sipas fushave dhe përcakton se cilat do të jenë pyetjet e maturantëve.

Ka ndryshime në formatin e testeve dhe për këtë janë trajnuar. Që nga kjo javë ne fillojmë edhe trajnimin e të gjithë mësuesve që japin mësim në shkollat e mesme sipas profileve, duke trajnuar drejtuesit e rrjeteve profesionale, për t'i udhëzuar se si do të punojnë me maturantët, për t'i udhëzuar maturantët se si do të jetë formati i testit dhe si do të jetë e gjithë mënyra e vlerësimit të testit, pasi edhe ajo ka ndryshuar nga një vit më parë.

Uroj që gjithçka të shkojë mirë. Ne do të marrim masa që administrimi të bëhet me korrektësi dhe me sukses, pasi ndikon shumë në rezultatet e maturës shtetërore.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Shumë faleminderit për shpjegimin e qartë që na bëtë!

Ftoj tani kolegët që, nëse kanë pyetje ose komente lidhur me “Paktin” apo edhe me Maturën shtetërore, t’ia adresojnë ministres dhe përfaqësuesve të ministrisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Patjetër, por me radhë.

Fjalën e ka kërkuar i pari zoti Nasufi, pastaj zoti Beqiraj.

**Fadil Nasufi** – Së pari, dua të falënderoj ministren dhe të gjithë stafin e saj për një paraqitje shumë analitike të materialit për informimin e komisionit, material ky, i cili, jo thjesht nga përmbajtja dhe informacioni në funksion të realizimit të pikave të “Paktit për universitetin”, por edhe për risitë që sjell Matura shtetërore, është një përgjigje shumë konkrete e problemeve të ngritura nga studentët gjatë kohës së protestave.

Brenda tre muajve vijmë edhe me një bilanc konkret arritjesh, që ministrja i bëri të njohura.

Këtu nuk është fjala thjesht të përshëndes ministren Shahini, por edhe ish-ministren Lindita Nikolla, sepse është një nismë e reformës në arsimin e lartë që nga viti 2013. Ne jemi optimistë që po marrim produktet e kësaj reforme, po marrim ndryshimet e kësaj reforme të pakthyeshme, që ka kërkuar jo pak sakrificë, jo pak mbështetje buxhetore dhe jo pak ndryshim mentaliteti në implementimin e ligjit të arsimit të lartë. Por, mbi të gjitha, na gëzon fakti që ka zgjidhje, duke iu referuar rezultateve konkrete të “Paktit për universitetin”, që nga punësimi dhe nga bursat e studentëve ekselentë.

Unë mendoj që jo thjesht komunikimin në këtë komision, por të gjejë edhe mundësinë për një transparencë dhe komunikim më të gjerë për publikun dhe për grupet e interesit që përfitojnë, sepse, në fund të fundit, janë arritje, por janë edhe buxhete, që dalin nga taksapaguesit shqiptarë dhe që u kthehen po kështu taksapaguesve në studentët përfitues dhe në mirëtrajtimin e fëmijëve që vazhdojnë arsimin e lartë. Kështu që, nisma në mbështetje të “Paktit për universitetin” po konfirmon që është e mbarë dhe zgjidhja që ka dhënë qeveria ka qenë, gjithashtu, një zgjidhje e shëndetshme, që ka plotësuar dhe do të plotësojë në vazhdimësi interesat e studentëve dhe ato të arsimit të lartë.

Së dyti, ne vetë kemi në fokus çështjet e arsimit, të sportit dhe të shkencës dhe kemi kryer edhe një axhendë. Këtë informacion nuk e kemi thjesht, siç na informon ministrja, por e kemi parë edhe vetë nëpër universitete, duke e nisur që nga dje. Mbi të gjitha ka ndryshuar mentaliteti i drejtimit dhe i bashkëpunimit të të gjithë trupës universitare dhe akademike.

Dje më gëzoi fakti që është gjetur kohezioni midis një konflikti shumë të zhurmshëm që është bërë midis drejtimit akademik dhe drejtimit administrativ, që konfirmon, në fund të fundit, autonominë e universiteteve dhe konfirmimin e faktit që ligji për arsimin e lartë aq shumë i kundërshtuar nga opozita, është një ligj europian, bashkëkohor, që po i bën mirë dhe po jep sinjalet e para të ndryshimit dhe transformimit të jetës nëpër universitete. Kështu që, këtu ka

shumë gjëra pozitive për t'u konfirmuar. Qeveria nuk e sheh këtë si një paketë të mbyllur, por si një paketë të hapur, ku do të kontribuojnë edhe aktorë të tjerë që nga vetë universitetet.

Edhe qeverisja vendore ka detyrime, që i kushtëzon "Pakti për universitetin". Një muaj më parë Ministria e Bujqësisë, nëpërmjet vëmendjes së Kryeministrit, i akordoi UBT-së gati 1 milion euro për ngritjen e Qendrës Didaktike Bujqësore, gjë që konfirmon vëmendjen e qeverisë për të bërë ndryshimin dhe për të sjellë progresin e duhur në universitete dhe në të gjithë arsimin në Shqipëri.

Tani po dal te disa pyetje që ndoshta u dhanë nga ministrja dhe nga paneli i ministrisë, por ndoshta duan një artikulum më të drejtpërdrejtë. Është çështja e konfliktit në shkollën në Kodër-Kamëz në aspektin e bllokimit për çështje pronësie, por që po na kthehet në një precedent. Sa herë që ka investime, opozita e kthen në një lloj kauze proteste dhe zhurme. Si është kjo çështje, që të mos na kthehen në risi këto angazhime bllokuese?

Në arsimin parauniversitar, cilat janë shkollat që financohen këtë vit në buxhetin e shtetit?

A ka filluar nga aplikimet Shkolla e Përgatitjes së Drejtorëve? Si po aplikojnë, sepse edhe ne si komision, kemi qenë në mbështetjen e Fondit Shqiptar-Amerikan dhe në përrurimin e shkollës, dhe në fillim të këtij viti do të kishin filluar aplikimet. Çfarë kriteri ka dhe në çfarë faze është?

Aty ka një kapitull për kartën e studentit, ku angazhohet edhe qeverisja vendore, kryesisht në qytetet universitare, si Vlora, Gjirokastra, Shkodra, Korça, Tirana. Ministrja tha në fjalën e saj se si ka filluar ky proces dhe si do të marrë rrugëzgjdhjen në vitin e ardhshëm akademik, por kush e udhëheq bashkëpunimin me qeverisjen vendore, sepse aktorët ngarkohen, por duhet një tryezë e përbashkët, ku të ulen universitetet, ministria dhe kryetarët e bashkive, që të mos i lënë në pritshmëri, sepse ka shumë palë, shumë aktorë, pra, kush e udhëheq këtë proces?

Për sa i përket Maturës Shtetërore, ju e sqaruat edhe në material, edhe në prezantimin që bëtë, që ka risi për shkak të kurrikulës së re, të kontrollit digjital dhe të ndryshimeve që janë bërë në provimet me zgjedhje dhe në provimet e detyruara, por a janë bërë sqarimet përkatëse për risitë e kësaj mature, sepse zakonisht maturantët udhëhiqen nga stereotipi dhe nga modeli pararendës. Që në shtator ata e vrasin mendjen se si do të jetë testi i qershorit dhe i referohen vitit 2018 për vitin 2019.

Tani është hera e parë. A jeni mjaftuar vetëm me komunikimin digjital dhe me transparencën *online* apo ka takime me studentët, me pedagogët dhe me të gjithë trupën që të

angazhohet që ky proces të ecë mbarë dhe përfitueshmëria të jetë e tillë, që të japë produktin që ka në pikënisje qëllimin e mirë dhe arrijtjen e një mature të pakontestuar dhe shumë rezultative?

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Urdhëroni, Ismet!

**Ismet Beqiraj** – Përshëndetje!

Edhe unë e kuptoj rëndësinë e këtij diskutimi dhe thirrjen e ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në këtë dëgjese, gjë që ky komision i nderuar e ka pasur si objekt kryesor të punës së tij gjatë gjithë kësaj periudhe për të gjitha problematikat, por dëgjesa e sotme ka një rëndësi të veçantë. Unë i bashkohem të gjitha vlerësimeve të bëra nga kolegu, por pjesa më e rëndësishme që shoh është se për herë të parë në historinë e arsimit të lartë kemi një “Pakt për universitetin”, ku katalizator për këtë ka qenë protesta e drejtë e studentëve në dhjetorin e kaluar. Qeveria, sigurisht, edhe ministria përkatëse, morën peshën e përgjegjësisë dhe detyrën e kodifikimit të të gjitha problematikave që nxori së fundi protesta e studentëve. Jo vetëm kaq, por të gjitha këto problematika përtej 8 pikave, dhe tani nuk janë thjesht 8 pika, por janë 8 pika plus dhe ai plusi pothuajse nuk ka një numër të kufizuar për të zgjidhur një sërë problemesh, në të gjithë zinxhirin e veprimtarisë dhe të jetës universitare në vendin tonë.

Kur them që është një katalizator dhe një e mirë për të gjithë shoqërinë shqiptare, për këtë shërbim publik shumë të rëndësishëm për të sotmen dhe për të ardhmen e brezit të ri, në këtë kontekst, edhe unë ndihem sinqerisht, shumë mirë, kur shoh se ky “Pakt për universitetin” po materializohet dhe nuk ka mbetur thjesht si disa kërkesa në një copë letër, thjesht për *show* dhe për qëllime politike dhe elektorale, por është kthyer në një produkt. Ndaj, të gjitha problematikat jo vetëm që janë kodifikuar, por janë përcaktuar për realizimin e tyre, janë shoqëruar me akte nënligjore përkatëse, të cilat angazhojnë përgjegjësitë jo vetëm të institucionit qendror në varësi, që është ministria, por edhe të fakulteteve.

Si produkt i “Paktit për Universitetin”, në materialin që na keni sjellë sot kemi edhe marrëveshjen e bashkëpunimit midis institucioneve përkatëse të linjës, ministrive dhe universiteteve, që janë një sërë detyrash në zbatim.

Unë e kuptoj padurimin e studentëve dhe kolegëve të mi në të gjitha universitetet, por gjithçka kërkon një kohë maturimi për t’u realizuar. Sinqerisht, mendoj se kjo është njësoj sikur t’i hedhësh një pikë vajguri gjellës për ta prishur. Është mirë që një pjesë vazhdon të kontestojnë, por ama duhet të shikojnë edhe realitetin me sy.

Për sa u përket tarifave dhe bursave, që zonja ministre nuk i përmendi në mënyrë specifike, deri tani përfitues të drejtpërdrejtë janë mbi 86 mijë studentë dhe kjo nuk është gjë e vogël. Përfitues të drejtpërdrejtë të reduktimit të tarifave janë mbi 71 mijë studentë në të gjithë Shqipërinë, përjashtim nga tarifat përfitojnë rreth 11700 studentë, përjashtim nga tarifa përfitojnë mbi 3200 studentë me familje në nevojë. Procesi vazhdon.

Jo vetëm kaq, por në kuadër të drejtimeve të tjera të Paktit për Universitetin dhe të marrëveshjeve të partneritetit midis universiteteve dhe ministrive ne dje ishim te Universiteti i Sporteve. Në dëgjuesën që patëm me personelin akademik në këtë universitet, mësuam se ata kanë nënshkruar një marrëveshje partneriteti me ministrinë për të gjitha problematikat që janë evidentuar nga studentët. Kjo gjë ndodh pothuajse në të gjitha universitetet e Shqipërisë.

Për sa i përket materialit që ju keni sjellë sot, zonja Ministre, unë kam disa pyetje, për të cilat do të bëj edhe komentet përkatëse.

Së pari, për sa u përket punësimeve, është gjë shumë e mirë që qeveria ka vënë në dispozicion të studentëve ekselentë të gjitha vendet e lira të punës në shërbimin civil dhe atë jo civil. Konstatoj se numri i studentëve që i drejtohen tregut privat është i vogël. Nga ana tjetër, punësimi në administratën shtetërore nuk duhet të kthehet në qëllim në vetvete dhe të dekurajojë objektivat e punësimit në frontin profesional, sepse, pavarësisht se këtyre u jepet mundësia për të marrë CV-në që ju duhet për të konkurruar, administrata është e limituar në numër, edhe pse do të vazhdojnë të dalin studentë ekselentë. Ndaj, është me interes të di, a ka projeksione të tjera nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për orientimin institucional në tregun profesional të punës të një fashe më të gjerë studentësh se studentët ekselentë? Sugjeroj që për këtë duhet një bashkëpunim qeveri -universitet - treg i punës, që deri tani ka munguar. Studentët nuk e njohin tregun e punës, kurse biznesi u qëndron larg institucioneve të larta të arsimit për përthithjen e studentëve.

Për sa u përket profesioneve fundamentale, të cilat janë pothuajse “profesione të rralla” apo “specie në zhdukje”, ministria duhet të nxisë politika. Për profesionet e shfrytëzimit të pasurive dhe burimeve natyrore që ka vendi ynë, këtu kam parasysh industrinë minerare, industrinë e naftës, industrinë e përpunimit të ujit të pijshëm dhe të baseneve, kërkesat pothuajse janë inferiore. Për të thënë të vërtetën, janë profesione ku dominojnë vajzat.

Për sa i përket antiplagjiaturës, a është blerë serveri? Blerja dhe vënia në funksion të institucioneve të arsimit të lartë e serverit për transparencën është përgjegjësi e ministrisë.

Për sa i përket marrëveshjes së partneritetit midis institucioneve të arsimit të lartë dhe qeverisë, e cila ka në fokus cilësinë akademike, mbështetjen e studentëve dhe infrastrukturën, unë kam disa pyetje, të cilat konsistojnë në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor. Konkretisht, në vendin tonë, në kushtet që jemi, kërkimi shkencor e dimë se si është dhe nuk është nevoja të bëjmë ndonjë koment. A ka ndonjë platformë të veçantë se si do të bëhet kjo?

Kërkimi shkencor është i lidhur me një sërë faktorësh. Faktori i parë është trupa akademike, e cila duhet vlerësuar më shumë.

Gjatë kësaj periudhe situata është fokusuar në kërkesat dhe në trajtimin e studentëve, por ama nuk duhen harruar edhe pedagogët, sepse futen në trinomin e cilësisë së lartë në arsim, pra është pedagogu, studenti dhe mbështetja financiare, dhe nuk mund ta prishim këtë trinom. Pra, për të rritur cilësinë në mësimdhënie dhe për të rritur cilësinë e kërkimit shkencor, një nga elementet kryesor është pedagogu.

Ne e dimë nivelin e trajtimit të pedagogut në Shqipëri dhe unë, si një pjesë e tyre, bëhem xheloz, pozitiv në këtë rast, për trajtimin jo të njëjtë të kolegëve tanë në Kosovë me ne në Shqipëri. Pra, është shumë mirë që gjatë kësaj periudhe vëmendja është fokusuar te studentët, por të mos harrojmë edhe pedagogët, sepse nuk mund të ketë universitet pa trupën akademike.

Unë mendoj që në 8 pikat të futet edhe strehimi social për pedagogët e rinj që rekrutohen, sepse ata janë në det të hapur. Pra, të ketë lehtësi kreditimi për ata.

Për studimet pasuniversitare, në kohën e brezit tim dhe më përpara, pra edhe ai shtet që i mori me vete gjithë kusuret pas viteve 90, kishte një vëmendje të veçantë për formimin dhe formatimin e trupës akademike. Por kjo le të jetë në perspektivë.

Ju përshëndes për bibliotekën *online*, e cila kishte mijëra tekste, disertacione, tema dhe leksione, por e rëndësishme për kërkimin shkencor është krijimi i kushteve të infrastrukturës teknike lidhur me laboratorët. Pra, kjo punë a mund të realizohet brenda buxhetit që miratua për vitin 2019, apo do të rialokohen fonde?

Drejt tjetër për kërkimin shkencor do të ishte aksesimi dhe prioriteti për aplikimet dhe angazhimet në projektet kombëtare qeveritare dhe të biznesit vendas, ku të përfshihen të diplomuarit dhe kandidatët për doktorantë, sepse nuk ka forca më të kualifikuara se në universitete.

Në fund, ne kemi marrë edhe një lajm të mirë, për hartimin e projektdetyrave, për projektin e kampusit universitar. A jeni në dijeni që ka një projekt për kampusin universitar të Universitetit të Tiranës dhe a do të inkludohet ky në këtë projekt?

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Të marrim edhe një pyetje të tretë dhe pastaj të marrim përgjigje për të tria pyetjet.

Fjalën e ka Adelina.

**Adelina Rista** – Faleminderit!

Fillimisht dua t'ju falënderoj!

Komisioni ynë është komision edukimi dhe në fokusin e tij ka problemet e arsimit, prandaj dua të falënderoj Ministrinë e Arsimit, sepse, sinqerisht, e ka vlerësuar gjithmonë dëgjuesën dhe ka ardhur këtu me seriozitet maksimal dhe me kompetencë profesionale, duke dhënë rezyme të qarta dhe të sakta, për atë çfarë ka arritur arsimit, që nga fillimet që kemi ardhur në pushtet dhe deri tani.

Sinqerisht ju falënderoj dhe e gjej me vend këtë falënderim për ish-ministren Nikolla, për ju dhe gjithë ekipin e Ministrisë së Arsimit për seriozitetin.

Të bësh reforma është e vështirë. Një qeveri, kur vjen në pushtet, ka vizionin e saj për të ardhmen dhe ky vizion fillon me arsimin. Reformat që janë bërë në Arsim, si me ligjin arsimin parauniversitar, si për arsimin profesional dhe për arsimin e lartë, kuptohet që duhet një peshë përgjegjësie dhe ndërgjegje maksimale për t'i çuar deri në fund. Pra, duhet të përballesh me të kaluarën, me të sotmen dhe të ecësh drejt të ardhmes.

Kjo qeveri e ka marrë përsipër të gjithë peshën e përgjegjësisë për ta çuar reformën e arsimit deri në fund. Pse? Sepse e ardhmja e këtij vendi dhe e fëmijëve tanë fillon tek arsimi, duke filluar me parashkollorin dhe deri në bankat e universitetit, të cilat janë trampolinë për t'u hedhur në jetë, me qëllim që kudo që të hidhen, të bien me këmbë në tokë. Pra, arsimit duhet të na dhembë të gjithëve. Në këtë këndvështrim unë them që është bërë shumë. Prandaj ju thashë që falënderimin e kam të sinqertë.

Mua më dhemb arsimit, sepse kam punuar për shumë vite në arsimin bazë dhe në të gjitha hallkat e arsimit.

“Pakti për univerisitetin”, këtu do të qëndroj te studentët ekselentë, që janë punësuar në administratën publike nëpërmjet shërbimit civil dhe jashtë shërbimit civil, dhe është një numër 373 me 86. Unë dua të di: kjo shifër totale si është në raport me numrin e atyre që kanë aplikuar për punësim në shtet, sepse shumë e gjejnë veten në subjektet private, pra jashtë administratës publike dhe administratës shtetërore? Pra, si është kjo shifër në raport me ata që kanë aplikuar? Këta që



kanë aplikuar a janë studentë që i kanë përfunduar studimet vitin e kaluar apo janë njerëz që i kanë përfunduar studimet vite më parë dhe aplikojnë për t'u punësuar në administratën publike apo jashtë shërbimit civil? Kaq kisha për arsimin e lartë dhe ju uroj suksese në zbatimin e të gjitha pikave të “Paktit për universitetin”.

Për sa i përket Maturës shtetërore, mund të them se në momentin që kurrikula e arsimit kalon në bazë kompetencash, është normale që të ketë edhe ndryshime. Ndryshimet që janë bërë për provimet e Maturës shtetërore janë nga dy provime, që kanë qenë me zgjedhje, kalohet në një; nga 23 lëndë, që ishte një gamë shumë e gjerë për të zgjedhur, kalohet në një numër më të ulët, dhe kjo është një gjë shumë e mirë; nga lëndë të detyrueshme, ku lënda e gjuhës dhe letërsia janë bashkë, megjithëse lëndën e gjuhës maturantët e bëjnë si lëndë më vete, gjuhë -letërsia është një provim, matematika dhe gjuha e huaj, gjithashtu. Janë krijuar: Komiteti i Maturës Shtetërore, komisionet e Maturës Shtetërore në drejtoritë arsimore dhe nëpër shkolla, si dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, ku të gjitha së bashku janë në shërbim të mbarëvajtjes së Maturës shtetërore. Unë dua të di: në momentin që në drejtoritë arsimore dhe në zyrat arsimore ka mungesë burimesh njerëzore, a ka pasur probleme në harmonizimin e marrëdhënieve ndërmjet komisioneve dhe komitetit? Kur do të plotësohen drejtoritë arsimore me kuadrin përkatës me burime njerëzore, sepse ato e ndiejnë këtë mangësi?

**Milva Ekonomi** – A mund t’ia jap fjalën edhe zonjës Nikolla dhe më pas ...?

**Adelina Rista** – Më falni, dua të shtoj edhe diçka.

A mendoni se të gjithë mësuesit e arsimit parauniversitar, duke filluar nga klasa e parë deri në gjimnaz, duhet t’i nënshtrohen provimit të gjuhës shqipe, përdorimit të gjuhës shqipe si në të folur, ashtu edhe në të shkruar, sipas standardeve të gjuhës letrare shqipe? Para pak kohësh kam parë një emision, ku pjesëtarët e një familjeje ishin mësues dhe kur filluan të shkruanin në dërrasë të zezë, sinqerisht të dy ata mësues linin shumë për të dëshiruar. A ka ardhur koha që tashmë provimit të gjuhës shqipe t’i nënshtrohen edhe mësuesit e arsimit parauniversitar, pra ta kalojnë si test më vete në kualifikimin e tyre?

Faleminderit!

**Lindita Nikolla** – U bashkohem falënderimeve të kolegëve për punën tejet serioze në gjithë paraqitjen e kërkesave nga ky komision, që është fakt i një pune shumë serioze që po bëhet për jetësimin e “Paktit për universitetin”, dhe jo vetëm, nga stafi drejtues dhe e gjithë skuadra e

arsimit. Unë besoj se tashmë jemi të gjithë të qartë dhe kemi rezultate të prekshme se si një protestë, nëpërmjet dialogut, arriti të bëjë më shumë sesa ishin kërkesat fillestare të protestës studentore.

“Pakti për universitetin” përveçse është një dokument dhe një sinergji e re në të gjithë jetën universitare, besoj se është një momenti i ri për të gjithë arsimin tonë të lartë, për të ofruar dhe për të mësuar një cilësi të re. Unë dua t’ju përgëzoj juve, zonja Ministre, si dhe stafin tuaj për gjithë punën që bëni çdo ditë në këtë drejtim! Patjetër ne do të shikojmë progres në të gjitha kontratat sociale të nënshkuara nëpërmjet ministrive të linjës dhe universiteteve përkatëse.

Edhe njëherë e përsëris: ne kemi shembullin më ekselent se si një protestë, se si vetëm nëpërmjet dialogut të një instrumenti të demokracisë të mund të ezaurohen, madje edhe të tejkalohen, kërkesat e protestës së studentëve.

Unë dua të ndalem në një moment tjetër të veçantë. Në fakt, ju e keni përshkruar shumë mirë në paraqitjen me shkrim që i keni dhënë komisionit, por ndoshta duke përfutur nga mediet, është rasti që të informojmë opinionin publik dhe prindërit për atë që po ndodh me Maturën shtetërore, si matura e parë e gjimnazit të reformuar. Kur ne filluam procesin e reformës së gjimnazit, kishim si synim largimin nga ajo situatë e një menyje të pafund lëndësh me zgjedhje, ku shpeshherë ndikonin negativisht në formimin e çdo gjimnazi, duke e unifikuar gjimnazin deri në klasën 11-të, duke i kufizuar lëndët me zgjedhje vetëm në gjuhët e huaja dhe në vitin e tretë në maturë kemi rritur menynë e lëndëve me zgjedhje. Pra, ky gjimnaz i reformuar nuk ka thjesht dhe vetëm kurrikulën e re, të orientuar nga kompetenca, por bën më së miri, rezultatet do ta tregojnë këtë vit, edhe lidhjen e munguar ndërmjet universiteti dhe gjimnazit, sepse në maturë gjimnazistët kanë ravijëzuar kërkesat dhe orientimet e tyre se ku do të vazhdojnë studimet e larta, nëpërmjet menysë me zgjedhje brenda vitit të Maturës shtetërore. Unë e di që ju keni punuar fort në këtë drejtim, por ndoshta është me interes për publikun që të dijë kriteret e përcaktuara nga universitetet për programet e pranimit, në përputhje me zgjedhjet që maurantët kanë bërë në maturë, sepse reduktimi i lëndëve me zgjedhje në provimet e maturës shtetërore ka pasur këtë qasje. Vetë matura e ka shtuar gamën e lëndëve me zgjedhje dhe maurantët tashmë janë shumë më të orientuar se ku do t’i vijojnë studimet e tyre në universitet. Nga ana tjetër, sa universitete po i përgjigjen kësaj kurrikule të re të reformuar, sepse kemi maturën e parë, që vjen në një shtrat krejt të ri kurrikular, por edhe aftësish për nga pikëpamja e kompetencave, sa dhe si universitet po i përgjigjen këtij formimi të ri, këtyre kompetencave të reja edhe çka do të vijë për maurantët në jetën universitare këtë vit?! Kjo është shumë e rëndësishme. Sigurisht, “Pakti për universitetin” ka preluar në të

gjithë komunikimin dhe informimin e publikut, por unë mendoj se kjo është një pikë shumë e rëndësishme kthese për jetën universitare dhe cilësinë në universitete, sepse vjen një brez i ri maturantësh me një kulturë dhe qasje krejt të re.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi**- Në fakt, ne patëm rastin për të parë materialin që erdhi në kohë dhe ishte përgatitur shumë mirë. Këtu thuhet se arsyet e mospagesave kanë ndodhur edhe për faktin se ka tejkalim të afatit të aplikimeve nga studentët. Pavarësisht nga tejkalimi, unë ju pyes nëse studentët që e përfitojnë bursën, do ta marrin atë? Kemi pasur raste në disa fakultete ku sekretaritetë nuk kanë punuar.

Nisur nga vizitat që kemi bërë në universitete, kemi parë që një pjesë e hapësirës publike të universiteteve është zënë në mënyrë të paligjshme me objekte pa leje, që nuk kanë fare lidhje me universitetin. A janë duke u marrë masa në drejtim të lirimit të ambienteve publike të universiteteve? Pra, a ka një nismë të këtij lloji për lirin e hapësirave?

**Mirela Kumbaro** – Unë ju falënderoj përzemërsisht, sepse keni pasur një volum pune shumë të madh, që nuk është bërë për 1 ose 2 muaj. Një falënderim i madh i takon studentëve, të cilët shpërthyen si ai sythi i luleve.

Një nga kërkesat e studentëve që ju e keni trajtuar me një sy të veçantë në parashtrësën tuaj, është Karta e studentit për të cilën tashmë është përgatitur VKM-ja përkatëse. Sado që në opinionin publik aplikimi i saj duket si diçka e thjeshtë, që mjafton të miratosh VKM-në dhe ajo automatikisht prodhohet, nganjëherë mund të jetë shumë më e vështirë, sepse nuk varet vetëm nga Ministria e Arsimit, por nga një koordinim i universitetit me shumë institucione të tjera private dhe publike. E them këtë, duke pasur parasysh ofertën e Ministrisë së Kulturës për Kartën e studentit që është e reduktuar, madje në disa aktivitete është zero pagesë, por kjo është pjesa më e lehtë, sepse e kishim tani të bërë edhe pa Kartën, deri te bashkëpunimi me bashkitë, me kompanitë private, të cilat kanë licencën e linjave të transportit dhe shumë oferta shërbimi që, në fakt, nuk janë fare publike, por mund të jenë kompani ose institucione private, të cilat sigurisht kërkojnë negociata nga Ministria e Arsimit.

Kur mendon Ministria e Arsimit se Karta e studentit do të jetë në dorën e studentit? Është më mirë ta dime, që të ndihmojmë si komision për të nxitur të tjerë aktorë që t'ju vijmë në ndihmë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me sondazhin për vjeljen e opinionit të studentëve lidhur me cilësinë e mësimdhënies së çdo pedagogu me emër dhe mbiemër. Është një instrument që do të

duhej të aplikohet dhe ne e morëm në angazhimet tona një element të tillë. Nuk e di nëse keni ndonjë projekt lidhur me zbatimin e këtij instrumenti, që e gjej shumë të rëndësishëm dhe shumë demokratik, transparent dhe nxitës për institucionet e arsimit të lartë!

**Besa Shahini**– Faleminderit shumë për pyetjet dhe komentet tuaja!

Sondazhi kombëtar i studentëve ka dy elemente, një është sondazhi kombëtar, që bëhet në nivel kombëtar për të matur cilësinë dhe pulsën e arsimit të lartë në Shqipëri. Pyeten studentët për mënyrën si e kanë përjetuar ata arsimin e lartë, pra edhe si eksperiencë studentore, por edhe për cilësinë e arsimit. Kjo është në realizim e sipër. Është krijuar metodologjia nga SAKAL-i, janë bërë edhe trajnime në universitete, që studentët të jenë gati për t'u përgjigjur te pyetëtori. Në javën e parë të majit do t'i mbyllim të gjithë pyetësorët dhe ne po shpresojmë që deri në mes të majit, do të kemi edhe rezultatet e para në nivel kombëtar dhe universiteti, por duhet gjithsesi sondazhi kombëtar, pra mënyra dhe metodologjia të reflektohet edhe në mënyrën se si universiteti i pyet studentët për vlerësimin e secilit pedagog. Këtë gjë nuk mund ta bëjmë ne, për shkak se kjo është përgjegjësia e universitetit, që t'i pyesin studentët se si ata e kanë përjetuar dhe e kanë perceptuar një pedagog të caktuar nga mënyra se si ai është sjellë me ta dhe se si e ka realizuar lëndën që ai jep, sepse kjo është një praktikë që realizohet kudo nëpër botë.

Ne ua kemi kërkuar këtë gjë universiteteve, pra me anë të marrëveshjeve që kemi dakordësuar dhe për të cilat jemi në proces nënshkrimi me secilin universitet, sepse ky është një obligim që universitetet duhet ta marrin përsipër. Nga ana jonë nuk do t'u mungojë dhënia e metodologjisë dhe çfarëdolloj mbështetjeje tjetër për të cilën ata kanë nevojë, por sondazhi i studentëve duhet të realizohet në nivel lënde. Gjithsesi, kjo është në proces e sipër.

Sa i takon kartës së studentit, në të nuk përfshihet vetëm vështirësia e marrëveshjeve me institucionet private, e cila në vetvete është mjaft e vështirë, pasi duhet negociuar shumë që ne të arrijmë atë që duhet për studentët, në mënyrë që ata të përfitojnë nga kjo kartë.

Gjithashtu, kemi edhe mjaft probleme të tjera, si mungesa e një sistemi të teknologjisë informative në Universitetin e Tiranës, e cila e vështirëson mjaft punën. Pra, ne duhet të dimë në çdo moment nëse studenti është ende student në Universitetin e Tiranës dhe për këtë duhet të shkojmë dhe të kërkojmë fizikisht nëpër regjistra, të cilët janë të shkruar me dorë, pasi ka mbi 2 vjet që ky sistem nuk funksionon mirë.

Kemi vështirësi të ndryshme, të cilat i kemi hasur rrugës, por të gjitha këto i kemi marrë parasysh, kur kemi kalkuluar orarin dhe jemi të bindur se për shtatorin e vitit 2019 do të jemi gati. Pra, kur të vijnë studentët në muajin tetor, do të jenë pajisur me Kartën e studentit.

Sa u takon mospagesave të bursave, kjo ka ndodhur për shkak se janë kaluar afatet e aplikimit. Ne u kemi kërkuar bordeve të administrimit shtyrjen e afatit dhe të pranojnë aplikime edhe përtej, sepse muajtë janar dhe shkurt kanë qenë si kanë qenë, jo të gjithë studentët kanë qenë të pranishëm në mësim dhe një pjesë e tyre nuk kanë qenë të vetëdijshëm për fitimin e bursës. Për këto arsye, ne u kemi kërkuar bordeve të administrimit të jenë sa më tolerantë dhe fleksibël për këtë pikë.

Ajo që mua më ka bërë më shumë përshtypje, dhe këtu shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje studentëve që të interesohen nëse e kanë fituar bursën dhe të hapin një llogari bankare, është se numri i studentëve përfitues është i madh, por ata ende nuk e kanë marrë bursën, sepse nuk kanë sjellë një llogari bankare pranë sekretarive të universiteteve.

Projektdetyra e Universitetit të Tiranës për investimet në infrastrukturë për Kampusin e Universitetit të Tiranës nuk do të bëhet vetëm këtu, por në të gjitha universitetet dhe ky është momenti që ne jemi duke i ndihmuar universitetet jo vetëm me projektdetyrën, por edhe me hapin tjetër, dizajnimin e projektit dhe preventivin, i cili do të bëjë të mundur investimin në këto universitete. Deri në fund të muajit shtator të gjitha këto projekte do të jenë gati, në mënyrë që në muajin tetor e më tutje të fillojë investimi në të gjitha universitetet dhe jo vetëm në Tiranë.

Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor do të bëhet nëpërmjet bibliotekës digjitale. Pra, nëse nuk ka mjaftueshëm burime mbi të cilat mund të kryhet ky kërkim shkencor apo akademik, studentët janë të justifikuar, nëse ata thonë se nuk e kanë arritur siç duhet kërkimin shkencor, për shkak se burimet në gjuhën shqipe janë të limituara, për arsye se ka pasur vetëm biblioteka fizike e jo digjitale. Sot ky arsyesim nuk do të ekzistojë më për të gjithë kërkuesit shkencorë, pedagogët, studentët, sepse edhe detyrat e kurseve që ata duhet të bëjnë në universitet, duhet të jenë në bazë të kërkimit shkencor dhe akademik. Kjo mundësi sot është e pranishme, aksesit për studentët është falas për 3 vjet dhe në këtë mënyrë ne do të arrijmë të shohim se cilat revista dhe libra janë përdorur më shumë, nëse ka të tjera që nuk janë të përfshira në këtë bibliotekë, por që u duhen këtyre universiteteve, në mënyrë që kontrata tjetër që do të bëhet pas 3 vjetësh, të jetë më e përshtatshme për universitetet shqiptare.

Punësimi në publik dhe në privat. Shumica e të diplomuarve punësohen në sektorin privat, por një problem që kanë universitetet, të cilin kemi kërkuar të adresohet sa më shpejt, është gjurmueshmëria. Çfarë bën studenti kur mbaron studimet? Punësohet në profesionin e tij apo në ndonjë profesion tjetër? A paguhet mjaftueshëm dhe në përputhshmëri me nivelin e studimeve apo paguhet më pak? Ajo çfarë ne dimë është se në Shqipëri sektori, i cili krijon më shumë vende pune dhe ku paguhet më së miri, është sektori që ka të bëjë me shërbime të ndryshme IT-je apo konsultuese nëpër banka, pra shërbime që eksportohen.

Nuk jemi të sigurt nëse oferta e universiteteve i përgatit mjaftueshëm studentët dhe të diplomuarit që të përfitojnë nga këto vende pune, të cilat janë në dispozicion të tyre dhe do të vijnë duke u shtuar. Për këtë arsye ne kemi organizuar një konferencë me pjesëmarrjen e të gjithë rektorëve, dekanëve, shefave të departamenteve për t'ua bërë të qartë, në mënyrë që ata t'i drejtojnë programet e tyre drejt nevojave për zhvillim ekonomik dhe social në Shqipëri, si dhe drejt ofertës së tregut, në mënyrë që të ketë një përputhshmëri më të madhe ndërmjet asaj që studiohet në universitet dhe asaj që ekziston si ofertë për punësim në tregun e punës.

Sa i përket punësimit në institucionet publike, studentët që kanë aplikuar janë ata me rezultate të shkëlqyera. Rastet kur ata nuk janë pranuar për një vend të caktuar pune, kanë qenë vetëm për arsyen se drejtimi i studimit nuk ka qenë i përputhshëm me atë që kërkonte vendi i punës. Janë rreth 850 vende pune të hapura me kontrata 1-vjeçare dhe ne kemi arritur të plotësojmë vetëm 460 prej tyre, ndërsa të tjerat janë në proces, por secili vend i ri pune që hapet në administratë, do të jetë në dispozicion, së pari, me kontratë 1-vjeçare për studentët dhe, më pas, do të hapet me procedurë të rregullt për shërbimin civil.

Konflikti në Universitetin Bujqësor të Tiranës na ka mërzhitur, për shkak se hapësira për të cilën është folur është private, e cila është shpronësuar për arsye se nevojat për shkolla të reja në Tiranë janë të mëdha. Duhet të kemi një gjë parasysh, mënyra se si zhvillohet Shqipëria demografikisht është se në zonat urbane gjithmonë e më shumë është e nevojshme prania e shkollave të reja, për shkak të migrimit të brendshëm, ndërsa në zonat rurale shkollat janë duke u zbrazur, për arsyen se qytetarët po vijnë gjithnjë e më shumë pranë zonave urbane.

Tirana është i vetmi qytet në Shqipëri ku ende mësohet me dy turne dhe që kjo të evitohet, kanë filluar të ndërtohen shkolla të reja. Bashkia e Tiranës bën shumë mirë që e bën këtë gjë.

Në zonën ku është Universiteti Bujqësor i Tiranës ka nevojë për një shkollë të re. Toka është e kampusit dhe është shpronësuar nga Bashkia e Tiranës. Ajo është vënë në dispozicion të shkollës së re.

Ne duhet të ulemi të gjithë së bashku, dhe po e bëjmë, që të gjejmë një zgjidhje, në mënyrë që Universiteti Bujqësor i Tiranës të mos ndihet sikur këtu është marrë një vendim pa u konsultuar me të. Ne e kuptojmë që është shumë afër kampusit, por nuk është pjesë e tij.

Sot kemi një takim me rektorin, me disa nga drejtuesit e universitetit, si dhe me kryetarin e bashkisë, që t'i japim drejtim kësaj çështjeje.

Në Universitetin e Shkodrës, javën e kaluar, është bërë një akt vandalizmi, plotësisht i paarsyetueshëm dhe i papranueshëm, sepse nuk ka pasur as protestë, as ndonjë arsye të madhe. Këtu duhet të vendosim një vijë të kuqe. Protesta është e pranueshme, kritikant janë të pranueshme, format e ndryshme të protestës janë të pranueshme, por vandalizmi i paarsyetueshëm nuk është i pranueshëm.

I kam kërkuar rektorit ta shohë me kujdes këtë dhe, me aq përgjegjësi sa ka, të marrë masa ndaj studentëve që kanë shkaktuar dëmin e pashpjegueshëm dhe të paarsyetueshëm.

Do ta mbyll këtu.

Për pyetjet që u bënë për Maturën, mund t'ju përgjigjet Zamira.

**Zamira Gjini – Faleminderit!**

Për sa u përket pyetjeve për Maturën shtetërore, dua t'ju informoj se ndryshimet për Maturën shtetërore në 2019-ën janë projektuar dy vjet më parë nga Ministria e Arsimit. Është ngritur një grup i madh pune me ekspertë të arsimit parauniversitar, si dhe me pedagogë të universiteteve. Ky grup ka pasur për detyrë të bëjë projektimin e kësaj mature të re. Mbas studimeve dhe diskutimeve, grupi i punës arriti në konkluzion me dy drafte të Maturës së re shtetërore. Më pas, duhej një vendimmarrje nga ministria dhe nga një grup më i ngushtë i ministrisë, për të përcaktuar modelin e Maturës shtetërore 2019.

Ne, si Ministri e Arsimit, i njoftojmë që një vit më parë maturantët dhe institucionet e arsimit të lartë për kriteret e pranimit në universitet. Kjo do të thotë se këtë vit ata nxënës që janë në klasën XI njihen me kriteret e pranimit në universitet për vitin akademik 2020-2021, pasi maturantëve në klasën XI do t'u duhet të zgjedhin lëndët për klasën XII.

Kur vendosëm kriteret për programet e studimit, në bashkëpunim me universitetet, një vit më parë, ministrja Nikolla ka thirrur të gjithë dekanët, shefat e departamenteve, rektorët, Institutin

e Zhvillimit të Arsimit, si dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore. Është diskutuar me ta për këtë maturë të re, për kriteret e reja që ata duhet të vendosin në Maturën shtetërore dhe për programet e reja në gjimnaze. E njëjta gjë ka ndodhur një vit më parë me maturantët që janë këtë vit dhe po ndodh edhe me maturantët në vitin e ardhshëm, në 2020-n, për të aplikuar në programet e studimit.

U bë një pyetje për mungesën e burimeve njerëzore në drejtoritë arsimore. Nuk kemi pasur probleme, pasi, edhe pse ka mungesa, komitetet e maturës shtetërore, me bazë drejtoritë rajonale apo zyrat arsimore, janë ngritur dhe kanë funksionuar. Deri tani procesi është pa ndonjë problematikë të rëndësishme.

U bë një pyetje edhe për Shkollën e Drejtorëve. Ne kemi ngritur një grup pune për të menaxhuar gjithë programin e Shkollës së Drejtorëve. Ka filluar krijimi i stafit të Shkollës dhe është emëruar drejtori i saj.

Më 21 mars është lançuar një raport studimi, ku një grup pune, i përbërë nga ekspertë vendas dhe të huaj, ka bërë një studim të nevojave për trajnime që kanë sot drejtorët dhe nëndrejtorët në sistemin parauniversitar. Sot kemi këtë raport, i cili do të na ndihmojë për të hartuar kurrikulat, që do të përdoren në Shkollën e Drejtorëve. Gjatë muajit prill ky raport do të punohet me të gjitha drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore, dhe do të ketë edhe një thirrje për ekspertët, që do të ndihmojnë në hartimin e kurrikulave të Shkollës së Drejtorëve. Po bëhen takime edhe me institucionet e arsimit të lartë, të cilat do të jenë bashkëpunëtore në realizimin e gjithë programit të Shkollës së Drejtorëve. Deri këtu jemi. Grupi i punës po punon edhe me nxjerrjen e akteve nënligjore, të cilat mund të kenë ndonjë ndryshim, për shkak të mënyrës se si do të rekrutohen drejtorët dhe nëndrejtorët e shkollave, pasi do të marrin këtë certifikim nga Shkolla e Drejtorëve.

Nuk e di nëse isha e qartë.

**Milva Ekonomi** – Faleminderit!

Kolegë, jemi të qartë me të gjitha përgjigjet?

Almira, doje të...

**Almira Xhembulla** – Faleminderit, zonja nënkryetare e komisionit!

Shumë faleminderit ministres dhe stafit të ministrisë për të gjithë informacionin që na dhanë! Dua të ritheksoj edhe një herë punën skrupuloze dhe shumë proaktive që u bë për “Paktin për universitetin”.

Më vjen mirë që edhe dje, në takimin që bëmë në Universitetin e Sporteve, morëm një *feedback* shumë pozitiv për procesin gjithëpërfshirës dhe këshillimor me aktorët dhe të gjitha



grupet e interesit. Sigurisht, ky proces u koordinua nga vetë Kryeministri, por jam shumë e kënaqur edhe me mënyrën se si ju e prezantuat. Më vjen mirë për reagimin tuaj qytetar, të kujdesshëm, por edhe shumë të vëmendshëm!

Kam edhe një merak tjetër. Duket sikur e gjithë energjia është fokusuar te “Pakti për universitetin” dhe puna e ministrisë është fokusuar te sistemi universitar.

Më vjen mirë për informacionin që dhatë për Maturën shtetërore, që jeni të vëmendshëm, si dhe për mënyrën se si po e koordinoni punën, sepse ky do të jetë ndër proceset më të rëndësishme në sistemin arsimor.

Desha të sjell edhe një herë në vëmendjen tuaj infrastrukturën shkollore, që në zona, për shembull, në rastin e zonës së Dibrës, duke qenë se u diskutua për problematikat e tjera dhe pavarësisht se ka kompetencë pushteti lokal, do të doja që nga stafi të shikohet me kujdes mundësia dhe hapësira që ka ministria për të investuar. Ka qenë edhe në planin e projektbuxhetit një shkollë e re. Nuk e di si është situata, por duhet ta keni në vëmendje, sepse është e rëndësishme edhe pjesa infrastrukturore, sidomos në zonat e thella.

E kemi diskutuar pjesën e mbylljes së shkollave, kur nuk ka nxënës, por flas për pjesën ku është shumë e nevojshme të punohet edhe në këtë drejtim.

Suksese dhe punë të mbarë për gjithçka që po bëni! Faleminderit!

**Besa Shahini** – Faleminderit për komentet tuaja!

Do të përgjigjem shumë shpejt për mënyrën se si vendosim për të ndarë buxhetin për investime të reja nëpër shkolla, që bëhet në nivelin e FZHR-së. Në fakt, ministria merr aplikimet që sjellin bashkitë. Për shembull, ka qenë një shkollë në Kukës, për të cilën kemi menduar se duhet të ketë investime, por nuk sollën aplikim. Shpresoj që kur të kemi një thirrje të dytë sivjet, ta sjellin. Pra, jemi pak të limituar nga aplikimet që sjellin bashkitë për të bërë gati projektet.

Vjet kemi krijuar një proces të inventarizimit të të gjithë infrastrukturës shkollore, ku janë identifikuar shkollat që kanë më shumë nevojë për investime dhe është bërë një kryqëzim i të dhënave mes tyre, ku kanë marrë prioritet sivjet, pasi fondi është gjithmonë më i vogël se dëshira që kemi për të investuar për infrastrukturën shkollore. Të shikojmë si po ecin investimet, nëse bashkitë kanë qenë me të vërtetë gati t’i përthithin këto fonde, dhe, në varësi të kësaj, është e nevojshme të bëhet edhe një thirrje e dytë në verë, siç ka ndodhur çdo vit. Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Mendoj që së fundi duhet të themi disa komente të përgjithshme.

Besoj se komunikimi shkrimor që patëm ishte i suksesshëm, sepse jo vetëm ndërtuam mundësinë e një bashkëbisedimi të këtij lloji, që të kuptonim problematikat dhe zgjidhjen e tyre, por duam t'ju falënderojmë edhe për vënien në dispozicion të një materiali shumë të mirë shkrimor, që duket sikur është zakon i ministrisë suaj, sepse komisioni përherë ka marrë një dokumentacion të plotë nga Ministria e Arsimit. Për ne është shumë e rëndësishme që “Pakti për universitetin” po shkon për së mbari dhe kërkesat po plotësohen njëra pas tjetrës, edhe pse në rrugën e plotësimit ka vështirësi normale që hasen në një implementim të këtij lloji.

Ne, siç edhe e dëgjuat, dje kemi qenë për vizitë në një universitet dhe aty pamë nga afër që ishte shumë i rëndësishëm komunikimi ndërpersonal midis pjesës akademike dhe administrative. Ai luan një rol deçiziv në mbarëvajtjen e universitetit dhe kjo na u dëshmuua dje në Universitetin e Sporteve. Për ata që janë administratorë nevoja e njohurive të thella financiare vjen si domosdoshmëri edhe për të bërë menaxhim të mirë të projektit “Exchange në akademi” apo të projekteve të tjera rajonale, duke ndihmuar kështu edhe performancën akademike. Këtë kuptuam dje në Universitetin e Sporteve dhe duam ta themi jo si këshillë, sepse ne nuk mund të japim një këshillë të këtij lloji, por ju duhet ta keni parasysh edhe në punët e përditshme të universiteteve.

Nga ana tjetër, ne e kuptojmë shumë mirë që nevoja për të thirrur studentët, që të jenë pjesë aktive e këtij dokumenti të gjallë, që ne e kemi quajtur “Pakt”, nuk është vetëm detyra juaj, por është edhe detyra e deputetëve të këtij komisioni. Secili nga ne, në zonat ku jemi, ku ka universitete, vazhdon të bëjë takime me grupet e interesave dhe studentët, për t'i ftuar ata për të qenë aktiv në komunikimin dhe në zbatimin e dokumentit të “Paktit”.

Nga ana tjetër, ne kuptojmë që është shumë e rëndësishme që të punojmë jo vetëm për “Paktin”, por për të gjithë këtë reformim që ka pësuar sistemi arsimor në Shqipëri, sepse, siç tha edhe zonja Nikolla, tani po kalohet stafeta nga arsimi parauniversitar në atë universitar, kështu që vëmendja duhet të jetë pak më e shtuar dhe për këtë arsye do të kishim nevojë që vazhdimisht të kishim dëgjesa me ju, për të parë këtë kalim që po ndodh në reformën në sistemin arsimor.

Nga vizitat që kemi bërë, duke shoqëruar Kryeministrin në zonat tona elektorale, kemi parë edhe diçka tjetër të rëndësishme. Ka shumë shkolla, qofshin këto të mesme apo profesionale, ku hapësira publike e nxënësve është zënë dhe ka nevojë që edhe ne, edhe dje e patëm këtë diskutim, të komunikojmë me bashkitë për lirimin e hapësirave publike dhe vendosjen e bazave eksperimentale në funksion të dijeve të nxënësve, duke u nisur edhe nga misioni i ri që ka marrë

përsipër arsimit parauniversitar, që është arsimim sipas kompetencave, e cila krijohet në një bazë prodhuese. Këtë e kemi parasysh edhe ne, si komision, që të bëjmë presionin tonë pranë qeverisjes vendore.

Reforma që është marrë në sistemin parauniversitar, po kurorëzohet tani me Maturën shtetërore. Ne e kemi bërë zakon që kur është përgatitja apo kur mbaron Matura shtetërore, bëjmë një dëgjese me Ministrinë e Arsimit, ndaj do t'ju thoshim se të njëjtën përkujdesje që keni pasur edhe më parë për rezultatin e Maturës shtetërore, të keni edhe për të na informuar ne për këtë vit akademik. Besoj se diskutimet tona të mëtejshme do të jenë në këtë formë, që të informohemi për ecurinë dhe të bëjmë pyetjet tona për zonat, edhe pse mund të mos jeni të gatshëm të jepni një përgjigje për zonën, sepse është shumë *mikro level* informacioni i kërkuar, por do të vazhdojmë me komunikimet me shkrim, siç kemi bërë edhe në të shkuarën.

Ju falënderojmë për kohën që na vutë në dispozicion dhe për shpjegimet shteruese!

Megjithatë, duhet të dini që ne kemi këtu një koleg, zotin Ismet Beqiraj, që nuk kënaqet kurrë nga përgjigjet, do gjithmonë më shumë, ndaj duhet ta keni parasysh në dëgjesat e tjera!

Faleminderit!

## **MBYLLET MBLEDHJA**